



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr 20351 Prot.
16

Patos, më 11/09 / 2024

PROCESVERBALI I TAKIMIT 11 SHTATOR 2024

Vendi: "Njësia Administrative Zharrëz "

Ora e fillimit: 10:00

Ora e mbarimit: 12:00

Dëgjesë publike me temë: "Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale 2025 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt dokumentit për hartimin e Buxhetit Afatmesëm 2025-2027".

Baza Ligjore: Në zbatim nenit 18 dhe 52 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 "Për njoftimin dhe konsultimin publik", ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", Rregullores së Këshillit Bashkiak "Për konsultimin publik", si dhe VKB nr. 71 datë 30.11.2023 "Mbi strukturën e nivelit të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2024" dhe VKB nr. 80, datë 18.12.2023 "Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2025-2027 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2025".

Pjesëmarrës: Kryetari i Bashkisë z. Fation Duro, Kryetari i Këshillit të Bashkisë z. Armand Ahmetaj, Deputete e Qarkut Fier znj. Antoneta Dhima, Sekretare e Këshillit znj. Refaela Xeba, Sekretare e Përgjithshme znj. Ermenita Mici, Drejtor i të Ardhurave Vendore z. Çajup Refitaj, Anëtarë të Këshillit të Bashkisë Patos, përfaqësues të subjekteve private dhe fermerë të cilët operojnë në teritorin e njësisë administrative Ruzhdie dhe rreth 60 pjesëmarrës (banorë dhe Kryetarë të fshatrave dhe përfaqësues të subjekteve që operojnë në njësisë Zharrëz).

Takimin hapet nga kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj

Kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj: - të nderuar të pranishëm! Ju falenderoj që jeni bërë pjesë të kësaj dëgjese publike. Në zbatim nenit 18 dhe 52 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe VKB nr. 80, datë 18.12.2023 “Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2025-2027 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2025”. Siç e kemi thënë edhe më parë ne kemi një rregull për dëgjesat, gjithsecili para se të kërkoj fjalën duhet të prezantohet me emër, pasi takimi rregjistrohet dhe çdo ankesë, propozim apo mendim i juaj do trajtohet në bazë të ligjeve në fuqi. Edhe njëherë ju falenderoj për pjesëmarrjen. Dëgjesën e deklaroj të hapur, fjala është për ekzekutivin për paraqitjen e materialit për paketën fiskale 2025.



**Kryetari i Këshillit
z. Armand Ahmetaj**

Dëgjesë publike me temë:

***“Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale
2025 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt
dokumentit për hartimin e Buxhetit
Afatmesëm 2025-2027”***

Shtator 2024

Drejtor i të Ardhurave Vendore z. Çajup Refitaj – faleminderit kryetar, më lejoni t’ju falenderoj për pjesëmarrjen tuaj në këtë takim konsultativ lidhur mbi prezantimin e projekt dokumentit të “Paketës Fiskale 2025” dhe sot jemi në fazën e parë të konsultimeve ku do të mbledhim propozimet tuaja për atë se çfarë mund të ndryshohet në këtë paketë lidhur mbi taksat tarifata dhe shërbimet, propozime të cilat do të reflektohen në dokumentin përfundimtar të paketës fiskale. Momentalisht kemi menduar që për vitin 2025 të paraqesim të njëjtën paketë fiskale, e cila është në fuqi e miratuar me VKB nr. 80 dhe prej vitesh është aplikuar nga bashkia Patos ku padiskutim kjo na jep avantazh për ta njohur më mirë këtë si dokument përfshirë edhe disa ndryshime të vogla, të cilat janë të përcaktuara nga qeveria. Përsa i përket komunitetit do të mbetet i njëjti nivel taksash dhe detyrimesh dhe përjashtimesh të miratuara në paketën aktuale ndërsa biznesi është subjekt i ligjit nr. 9920 dhe do të jenë të njëjtat nivele taksash, tarifash dhe shërbime dhe afati i shlyerjes do të jetë deri në 30 qershor të vitit kalendarik. Ne jemi duke parë me grupin

e menaxhimit vendosje e tarifave të reja për kryerjen e shërbimeve në shtëpi banimi për qytetarët do të jetë 5 mijë lekë të rinj ndërsa për subjektet në vlerën 10 mijë lekë të rinj, por edhe tarifa të tjera të cilat lidhen me marrjen e aseteve të bashkisë. Ndërsa për taksat familjare do të jemi në të njëjtat nivele pagesash si dhe kategorish përjashtimore.



**Drejtor i të Ardhurave vendore
z. Çajup Refitaj**

Dëgjesë publike me temë:


***“Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale
2025 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt
dokumentit për hartimin e Buxhetit
Afatmesëm 2025-2027”***

Shtator 2024

Gjithsesi jemi në fazën e marrjes së propozimeve tuaja për ndryshime që do të pasqyrohen në draft dokumentit përfundimtar të paketës fiskale, e cila do të prezantohet përsëri në komunitet për të kaluar më pas në miratim nga këshilli bashkiak. Për çdo pyetje komente apo sygjerime jam i hapur për diskutim, Faleminderit!

Kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj- faleminderit Çajup, për prezantimin e draft dokumentit fjala është për ju për pyetje sygjerime komente lidhur mbi draft dokumentin e paketës fiskale.

Banor i njësisë Zharrëz z. Tajar Hajdini- unë kam një shqetësim i cili lidhet me përroin e Zharrëz ka ujë apo jo e keni parë ndonjëherë? Në 2014 janë hedhur miljarda lekë kush i mori kanë ujë kanalet apo nuk kanë?



**Banor i njësisë Zharrëz
z. Tajar Hajdini**

Dëgjesë publike me temë:

***“Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale
2025 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt
dokumentit për hartimin e Buxhetit Afatmesëm
2025-2027”***

Shtator 2024

Banor i njësisë Zharrëz z. Agur Ferra - faleminderit për gjithë fjalët e bukura që thatë, por ne nuk kemi rrugë për të shkuar te shtëpia.

Taksat ju po i ngrini, ne po i paguajmë, liqeni thoni ju ka ujë por asnjëherë nuk është parë nëse ka apo jo, unë them se nuk ka ujë dhe ne nuk kemi ujë për vaditje të tokave për çfatë taksash vini dhe na prezantoni kur nuk marrim shërbim?



**Banor i njësisë Zharrëz
z. Agur Ferra**

Dëgjesë publike me temë:

***“Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale
2025 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt
dokumentit për hartimin e Buxhetit Afatmesëm
2025-2027”
Shtator 2024***

Kryetari i fshatit Frashër z. Irakli Zarka - një pyetje kam lidhur mbi taksat, familjet emigrante të cilët nuk janë rezidentë në Shqipëri a duhet të paguajnë taksa pasi nuk më duket normale që emigrantët që vijnë një herë në vit të paguajnë . Një kërkesë tjetër kam pastrimim e përroit në fshatin Frashër.



**Drejtor i të Ardhurave vendore
z. Çajup Refitaj**

Dëgjesë publike me temë:

***“Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale
2025 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt
dokumentit për hartimin e Buxhetit
Afatmesëm 2025-2027”
Shtator 2024***

Banor i njësisë Zharrëz z. Myqerem Pëllumbi – ne si fshat kemi një problem të madh me furnizimin me energji elektrike nga Albpetroli dhe në dijeninë time ky shqetësim është ngritur edhe nga banorë të tjerë dhe nuk është marrë asnjë masa nga ana e bashkisë pasi prej mungesës së fuqisë së energjisë elektrike po na digjen paisjet shtëpijake. Gjithashtu kemi problem me mungesën e sistemit të vaditjes dhe me të drejtë parafolësi tha çfarë tarifash kërkon të paguajmë kur nuk kemi shërbim. Fshati po nuk pati ujë për vaditje vdiq, nuk prodhohet asgjë po nuk pati ujë.

Banor i njësisë Zharrëz z. Bilbil Asllani – keni shtruar një rrugë për në Zabie lartë nuk është përfunduar dhe të gjitha punimet kanë mbetur përgjysëm të papërfunduara.

Do të bëhen kanalet dhe do të shtrohen rrugët por përpara se të punohet për shtrimin apo hapjen e rrugëve si fillim duhet të pastrohen kanalet. Ju bëni punime atje ku nuk paguhen taksat. Bashkia ka inventar të tokave të cilat i ka zënë nafta



**Banor i njësisë Zharrëz
z. Bilbil Asllani**

Dëgjesë publike me temë:

*“Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale
2025 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt
dokumentit për hartimin e Buxhetit
Afatmesëm 2025-2027”*

Shtator 2024

Përfaqësues i shoqatës ambientaliste Zharrëz z. Qani Rredhi – në njësinë Zharrëz po punohet me ujësjellësin dhe doja të dija kush është supervizori që kontrollon punimet dhe pasi të marr përgjigjen nga Kryetari do të shpreh opinionin dhe shqetësimin tim si organizatë ambientaliste.



**Përfaqësues i shoqatës ambientaliste Zharrëz
z. Qani Rredhi**

Dëgjesë publike me temë:

*“Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale
2025 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt
dokumentit për hartimin e Buxhetit
Afatmesëm 2025-2027”*

Shtator 2024

Banor i njësisë Zharrëz z. Fuat Bani – pasi ju dëgjuam dhe me të drejtë kërkoni pagesën e taksave, por ne jemi 50 familje të cilat nuk kemi ndriçim rrugorë, ujra të zeza nuk kemi, ujë të pijshëm nuk kemi edhe për vaditjen ne kemi siguruar vet duke shpuar puse pasi nuk kemi sistem vaditje të ofruar nga bashkia ndaj do t'ju lutesha të shikonit mundësinë për të na ofruar shërbimin, Pasi ne si banor nuk kemi marrë asnjë shërbim nga bashkia.

Nëse ka mundësi nga këshilli të merret vendim që ato familje që nuk marrin shërbim të mos paguajnë pasi nga bashkia nuk marrim gjë.

	<p>Banor i njësisë Zharrëz z. Fuat Bani</p> <p>Dëgjesë publike me temë:</p> <p><i>“Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale 2025 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt dokumentit për hartimin e Buxhetit Afatmesëm 2025-2027”</i></p> <p>Shtator 2024</p>
---	---

Banor i njësisë Zharrëz z. Enver Hasani – kemi një problem të madh lidhur mbi certifikimin e tokave pasi janë të pa azhornuara. Si do të zgjidhet ky problem pasi tokë kemi por nuk bëhemi dot pronar të ligjshëm. Dua të ndaj tokën por nuk e ndaj dot. Një problem tjetër që doja të ngrija, unë ka të bëjë me vendin ku unë banoj tek sektori i SMT-së Zharrëz, ai është një objekt i vjetër që kërkon ndërhyrje në riparimin e tij pasi prej amortizimit i bien tullat dhe mund të dëmtojë njerëzit që kalojnë apo edhe fëmijët që mund të shkojnë pranë objektit për të luajtur.

	<p>Banor i njësisë Zharrëz z. Enver Hasani</p> <p>Dëgjesë publike me temë:</p> <p><i>“Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale 2025 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt dokumentit për hartimin e Buxhetit Afatmesëm 2025-2027”</i></p> <p>Shtator 2024</p>
---	--

Banore e Njësisë Zharrëz znj. Bedrie Lazaj – kam një problem lidhur mbi gardhet të cilat kanë zënë rrugën kryesore dhe unë parkoj makinën te pallatet pasi kam vite që i shërbej këtij komuniteti me subjektin që kam por nuk kam ku të parkojnë automjetet. Sot mua më vjen nga bashkia një

shkresë për largimin e mjetit tim nga vendi te pallatet me pretendimin se kam zënë hapësirën. Unë nuk kam ku të parkoj mjetin, ose të hiqen gardhet ose më përcaktoni vendin ku të parkoj makinën, ta paguaj më jepni një shpjegim.



**Banore e Njësisë Zharrëz
znj. Bedrie Lazaj**

Dëgjesë publike me temë:

***“Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale
2025 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt
dokumentit për hartimin e Buxhetit
Afatmesëm 2025-2027”
Shtator 2024***

Banor i njësisë Zharrëz z. Namik Plepi – doja të ngrija si shqetësim të parë problemin e elektrikut për mos furnizimin e fshatit tonë me energji, një problem ky i trashëguar dhe i ngritur prej banorëve për vite e vite me radhë. Problem tjetër madhor ka të bëjë me kanalet kullues. Komisioni i ngritur prej bashkisë ka piketuar dhe përcaktuar vendet se ku do të punojë skrepi për pastrimin e kanaleve kullues , por nuk kanë parë apo është përcaktuar ndërhyrja në parcelën 88 kanali ka një gjatësi prej 1 km, e cila ka nevojë për ndërhyrje emergjente pasi janë 30 ha tokë bujqësore, të cilat përmblyten çdo vit pasi fillojnë shirat dhe përroi del nga shtrati dhe përmbut parcelat bujqësore duke shkaktuar dëme të konsiderueshme te fermerët.



**Banor i njësisë Zharrëz
z. Namik Plepi**

Dëgjesë publike me temë:

***“Konsultimi i ndryshimeve të Paketës
Fiskale 2025 dhe rishikimi i ndryshimeve
të projekt dokumentit për hartimin e
Buxhetit Afatmesëm 2025-2027”***

Shtator 2024

Kryetari i Bashkisë z. Fation Duro – duke ju falenderuar paraprakisht për të gjitha shqetësimet e ngrituara prej jush më lejoni t’ju informoj se bashkia këtë vit por edhe vitin tjetër në njësinë

Zharrëz do të investoj në shtrimin e 12 rrugëve. Kryetari i bashkisë prezanton emërtimin e rrugëve në të cilat do të investohen për shtrim me asfalto beton dhe çakull.

Jo vetëm në njësinë Zharrëz, por në të gjitha parcelat e varrezave publike të cilat janë 47 parcela do të investohet në vendosjen e sisemit të ujit por edhe në rrethmin e tyre. Lidhur mbi skemën e vaditjes, ka filluar puna në fshatin Belinë gjithashtu në fshatin Sheqishte për të bërë dy stacione të vogla pompimi për të provuar sistemin e vaditjes me tubacion dhe nëse na rezulton i suksesshëm do ta aplikojmë edhe në fshatrat të cilat nuk e kanë sistemin e vaditjes dhe Zharrëza me përfundimin e ujësjellësit do të marri ujë nga patosi.



**Kryetari i Bashkisë
z. Fation Duro**

Dëgjese publike me temë:

*“Konsultimi i ndryshimeve të Paketës
Fiskale 2025 dhe rishikimi i ndryshimeve të
projekt dokumentit për hartimin e Buxhetit
Afatmesëm 2025-2027”*


Shtator 2024

Lidhur mbi investimin e ujësjellësit ai është një investim që kryhet nga AKUM-i dhe nuk mund të them se kush është suvervizori pasi nuk është investim i bashkisë dhe bashkia ka dhënë vetëm lejen e infrastrukturës. Rruga në lagjen Belulaj është parashikuar për t’u shtruar me asfalt. Lidhur mbi inventarin e tokave është ngritur grupi i punës, i cili po punon për inventarizimin jo vetëm të tyre, por edhe të kanaleve kullues. Lidhur mbi ndriçimin rrugor nga bashkia është parashikuar shtimi i segmenteve rrugore të cilat kanë nevojë në sistemin e ndriçimit, dhe do të mundohemi të futemi në çdo fshat për ndriçimin rrugor, ndërsa lidhur mbi problemin e dritave në fshatin Verbas, do të jem në kontakt me kompaninë Albpetrol, pasi edhe energjia elektrike që ju merrni është prej kësaj kompanie. Problemi i gardheve te pallatet dykatëshe, zonja që e ngiti si problem, keni ndërtuar dy garazhe në atë ambient dhe gardhet do të hiqen pasi e gjithë ajo zonë do të rehabilitohet dhe do t’ju kthehet banorëve. Problemi i sistemit të kullimit, bashkia do të vazhdojë punën për pastrimin e tyre. Lidhur mbi problemin e certifikimit të pronave, duhet të shohim se si do të vazhdojë procesi i azhornimit nga ana e hipotekës, ne kemi bërë kërkesa hipotekës dhe jemi në pritje.

Banor i njësisë Zharrëz. Z. Bilbil Asllani - doja të dija lidhur mbi problemin e urës a ka ndonjë projekt nga ana e bashkisë?

Kryetari i bashkisë z. Fation Duro – patjetër që do të ndërhyet nga ana e bashkisë për ngritjen e anësoreve të urës.

Anëtari i Këshillit të bashkisë z. Erald Çepele – doja të pyesja tarifa për deklarimin e kryerjes së punimeve për çatitë e pashfrytëzueshme keni parashikuar vendosjen e një tarife prej 50 mijë lekë, por a do të ndihmohen qytetarët nga bashkia për hartimin e projekteve?



**Anëtari i Këshillit të bashkisë
z. Erald Çepele**

Dëgjesë publike me temë:

*“Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale
2025 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt
dokumentit për hartimin e Buxhetit
Afatmesëm 2025-2027”
Shtator 2024*

Kryetari i bashkisë z. Fation Duro - në rang vendi ne jemi bashkia që do të aplikojë tarifën më të ulët lidhur mbi marrjen e këtij shërbimi leje për ndërtimin e çatitë të pashfrytëzueshme në vlerën 5 mijë lekë, leje e cila kërkon si dokument shoqëruës planin e vendosjes në vlerë 10 ose 20 mijë lekë, ndërsa për shërbimin leje për ndërtim të murit rrethues, i cili përveç dokumentacionit përkatës do të ketë si dokument shoqëruës planin e rievimit dhe ka një tarifë prej 30 mijë lekë do të ofrohet nga bashkia. Planin e vendosjes mund ta bësh edhe në topograf privat edhe me topografin e bashkisë.



**Kryetari i Bashkisë
z. Fation Duro**

Dëgjesë publike me temë:

*“Konsultimi i ndryshimeve të Paketës
Fiskale 2025 dhe rishikimi i ndryshimeve të
projekt dokumentit për hartimin e Buxhetit
Afatmesëm 2025-2027”
Shtator 2024*

Përfaqësues i Shoqatës Ambientaliste Zharrëz. Z. Qani Rredhi – ju falenderoj Kryetar që nuk harruat t'i kthenit përgjigje pyetjes sime e cila nuk ishte pa arsye pasi mbi tubot e ujësjellësit janë duke u hedhur gurë të mëdhenj dhe pasojat do të jenë pas disa vitesh pasi mbi tubot duhet të hidhet rërë dhe jo gurë.



**Përfaqësues i shoqatës ambientaliste Zharrëz
z. Qani Rredhi**

Dëgjesë publike me temë:

*“Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale
2025 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt
dokumentit për hartimin e Buxhetit Afatmesëm
2025-2027”*

Shtator 2024

Një shqetësim tjetër që unë kam ngritur prej kohësh është ndihma dhe mbështetja që mund të na jepni ne si banorë për pastrimin e gropave pranë qendrave të banuara si dhe rrethimi i tyre pasi rrezikohet jeta e banorëve.

Kryetar i bashkisë z. Fation Duro – shqetësimi juaj mbi supervizimin e punimeve do t'ja përcjell ujësjellësit, po kështu do të vihet në zbatim projekti për pastrimin e gropave të serave pranë qendrave të banuara ku do të përfshihet edhe rrethimi i tyre.



**Kryetari i Bashkisë
z. Fation Duro**

Dëgjesë publike me temë:

*“Konsultimi i ndryshimeve të Paketës
Fiskale 2025 dhe rishikimi i ndryshimeve të
projekt dokumentit për hartimin e Buxhetit
Afatmesëm 2025-2027”*

Shtator 2024

Drejtor i të Ardhurave Vendore z. Çajup Refitaj - më lejoni t'ju informoj se lidhur mbi shqetësimin e ngritur për faturim të shërbimit të vaditjes atë do ta paguajnë vetëm fermerët të cilët e marrin këtë shërbim. Në rast se nuk merr shërbim nuk e paguan. Ndërsa lidhur mbi shqetësimin e emigranëve të cilët janë rezident në një shtet tjetër dhe kur kthehen në atdhe për të marrë një

shërbim i'u kërkohet libreza e taksave dhe tarifave vendore jemi duke punuar mbi përcaktimin e dokumentacioneve për përjashtimin e tyre nga pagesa e tarifave dhe shërbimeve, por jo nga taksa e pronës.



**Drejtor i të Ardhurave vendore
z. Çajup Refitaj**

Dëgjuesë publike me temë:

***“Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale
2025 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt
dokumentit për hartimin e Buxhetit
Afatmesëm 2025-2027”***

Shtator 2024

Kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj: - faleminderit ekzekutivit për sqarimin e dhënë. Ndonjë pyetje apo koment tjetër për paketën fiskale 2025?

Mqse jo edhe një herë ju falenderoj për rëndësinë që i kushtuat këtij takimi, por dhe mendimeve, pyetjeve, sygjerimet e dhëna prej jush duke orientuar punën e bashkisë në përpilimin e draft dokumentit të paketës fiskale i cili do të prezantohet edhe në muajt në vijim tek ju. Edhe një herë faleminderit!

Koordinator i Konsultimit Publik

Suzana Hysenaj

Sekretar i Këshillit

Refaela Xeba

Foto të takimit me temë: “Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale 2025 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt dokumentit për hartimin e Buxhetit Afatmesëm 2025-2027”



